

## **SPECIFIKIME TEKNIKE PER MATERIALET E NDERTIMIT**

1. Materialet e ndertimit do te furnizohen sipas zerave te pasqyruara ne preventive .
2. Materialet inerte, çimento, gelqerja, do te furnizohen sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor brenda afatit te kontrates.
- 3- Rera e betonit, rera e suvatimit duhet te jene materiale te kaluara ne makinerite e larjes dhe te pastrimit dhe pa permbajtje dherash.
5. Çimento duhet te jete sipas normativave dhe standarteve te miratuara e klases 32.5 N, e ambalazhuar ne masen 0.25kv dhe e shoqeruar me dokumentin e dates skadences.
6. Boja e vajit duhet te jete per lyerje materiale hekuri, e ambalazhuar ne kuti 1kg. Ngjyrat e bojës duhet te jene sipas kerkeses se A.K
6. Boja akrelik dhe hidromati duhet te jete e ambalazhuar ne kova 5-15 kg  
Boja akrelike dhe hidromat duhet te plotesoje te gjitha parametrat teknike per lyerje te siperfaqeve te jashtme dhe te brendshme dhe te jene te shoqeruara me fleten e dates se skadences.
7. Pigmentet do te merren te ambalazhuara ne masen 0.5-1kg sipas ngjyrave te percaktuara nga AK ne momentin e furnizimit.
8. Stuko patinimi duhet te jete e ambalazhuar ne masen 15 kg dhe e shoqeruara me fleten e skadences
10. Bordurat e betonit do te jene beton te armuar, ne siperfaqe te niveluar mire dhe me ngjyre gri , me permasa 1mx0.12 x 0.20 mm.
13. Hekur ELE 10×10 duhet te jete ne shufra me gjatesi 6 ml
14. Tubi I hekurit duhet te jete me diameter 10 mm dhe furnizimi me gjatesi 6 ml.

**CIMENTO, FINO, STUKO, BOJE VAJI, HIDROMAT, ALLÇI, PIGMENTE BOJAK, DUHET TE JENE ME FLETE SHOQERUSE SKADIMI TE MATERIALEVE.**

Te gjitha materialet duhet te jene cilesore dhe perpara furnizimit duhet te miratohen sipas specifikimeve per secilin material pastaj te behet furnizimi.

Veglat e punes do te jene sipas specifikimeve te shkruara ne preventiv

Veshjet e punes duhet te kene logon e Institucionit.

## **SPECIFIKIME TEKNIKE PER MATERIALET QE NEVOJITEN PER SHERBIMIN “MARANGOZ”**

### **BRAVAT AUTOMATIKE**

Bravat e dyerve automatike duhet te jene te kompetuara ne kuti dhe fishek me nga 3-5 kopjo celsi.  
Brave 13cm

### **GOZHDE E THUMBA**

Dimensionet e gozhdeve dhe thumbave te jene 4-7cm .

### **SHKUMA**

Duhet per fiksimin e kasave te dyerve te drurit. Per kete material duhet te respektohet patjeter afati i skadences ne ditën e furnizimit dhe ky afat te mos jete me I vogel se nje vit, per ndryshe te parashikohet furnizimi me afat.

### **DOREZA PER DYER (AUTOMATIKE DHE D/ALUMINI)**

Duhet te zevendesohen ne shume dyer ku bravat bravat dhe fisheku mund te jene ne gjendje te mire, por dorezat jane amortizuar ose keputur. Mos vendosja e tyre con ne prishjen e braves dhe te fishekut.

### **TENIJA**

Do te perdoret ne punimet e marangozit ne punimet me melamin.

### **MENTESHA DERE**

Do te perdoren per zevendesimin e menteshave te dyerve ne rastet kur do te behet fiksimi I kasave me shkume ose ne rastet kur menteshat eksistuese keputen ose shtremberohen. Menteshat duhet te jen me hapje ne te dyja krahet dhe materiali te jet celik.

### **DOREZA KOMODINE/DOLLAPI**

Dorezat e komodinave dhe te dollapeve duhen te jen modeli rrumbullak dhe ngjyra te jet kafe.

### **SILIKON**

Silikoni duhet te jet i nenshkuar ose i shoqeruar me date skadence.

### **DISQE SHARRE**

Disqet e sharres duhet te jen materiali celik per dru dhe per melamin.

Disk sharre per prerje druri me diameter 30cm (300mm)

Disk sharre per prerje melamine me diameter 30cm (300mm)

### **VIDIATOR**

Vidiatori duhet te jet me bateri 18V. duhet te shoqerohet me kutin perkatese. me dy bateri dhe nje karikues dhe me nje set kokash kacavidash.

### **SET PUNTO DRURI**

Puntot e drurit duhet te jen material celik,seti te ket permasat e puntos 3-10mm

### **GRILA AJRIMI**

Grilat e ajrimit duhet te jen rrethore 200mm I materialit alumin

### **SHKALLE METALIKE**

Shkallet duhet te jen metalike I modelit A5 me gjeresi 33 cm,lartesia 100- 195 cm,dhe me peshen maksimale 100kg

### **MBAJTESE BICIKLETASH**

Mbajtese bicikletash duhet te jen rrethore te dimensioneve te ndryshme dhe ngjyrat do miratohen ne momemtin e furnizimit. Tubi do jete Ø40mm me spesor 3mm.



### **METER SHIRIT**

Meter shirit i cili duhet te bej matje deri ne 10ml.dhe trashesia te jet 19mm